



42 27.03.2013  
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 27.03.2013

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2013, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 2, pika 1.5, nenin 5 pika 1.5, nenin 6 pika 2.9 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233 (Gazeta Zyrtare Nr. 85/2010), nenin 27 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012 mori:

V E N D I M

- I. Për mos-shfrytëzimin e resurseve natyrore, me qëllim të përpunimit dhe marrjes së gurit dhe zhavorrit në Zonën Kadastrale Bardh i Madh, në lokacionin e quajtur 'Zojë' ('Gospojë').
- II. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

A r s y e t i m

Komuna e Fushë-Kosovës, me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, 2012-2016, të miratuar nga Kuvendi i Komunës, me vendimin Nr. 74, të datës 18.06.2012, zonën e 'Zojës' ('Gospojës') e ka të caktuar 'zonë të mbrojtur me vlerë të veçantë natyrore'. Komuna e Fushë-Kosovës pjesën më të madhe të territorit të saj, e ka zonë të urbanizuar, industriale dhe fushore. Posedon sipërfaqe të vogël pyjore, nga periferia e fshatit Sllatinë e Madhe/Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm, andaj kjo zonë është e vetmja pjesë e territorit tonë ku qytetarët mund ta shfrytëzojnë për rekreacion, njëherësh konsiderojmë se kjo zonë është e pasur me disa lloje të 'florës' dhe 'faunës'. Po ashtu sipërfaqja pyjore në fshatin Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm në gjerësinë e saj konsiderohet 'zonë arkeologjike'.

Duke marrë parasysh karakteristikat e cekura më lart, konsiderojmë se mundësia e lejimit të Kompanisë 'Bechtel-Enka' për shfrytëzimin e resurseve natyrore në vendin e quajtur 'Zojë' ('Gospojë'), është në kundërshtim me parimin e cekur në nenin 6, pika 8, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, në kundërshtim me nenin 2, pika 1.5, me parimet e mbrojtjes së natyrës, neni 5, pika 1.3 dhe 1.5, nenin 6, pika 2.9, të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233.

Për mos-shfrytëzimin e resursit natyror - materialit, me qëllim të përpunimit dhe marrjes së gurit dhe zhavorrit, qytetarët e fshatrave Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës dhe përmes protestës qytetare, të mbajtur në fshatin Bardh i Madh më datë 20.03.2013, kanë kërkuar nga institucionet relevante lokale dhe qendrore që zona pyjore e 'Zojës' ('Gospojës'), të mos lejohet për shfrytëzim.

**Akti i dorëzohet:** Zyrës së Kryeministrit, Minisitrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Agjencionit Pyjor të Kosovës, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për PUKGJ, Drejtorisë për SHPM, Drejtorisë për INSPK dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Jakup Ternava

